

PLANI STRATEGJIK I VEPRIMIT 2024 – 2026

PLANI STRATEGJIK I VEPRIMIT 2024 – 2026

PËRMBAJTJE

NË VEND TË HYRJES	04
MISIONI	06
VLERAT	06
ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	07
QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT	09
1. NXITJA DHE MBESHTETJA E STANDARDEVE PROFESIONALE NË RRRITJE TË TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE NËPËRMJET PRAKTIKAVE MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE	09
2. SIGURIMI DHE NXITJA E DIVERSITETIT DHE E PLURALIZMIT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE	09
3. QASJE PROAKTIVE PËR TRANSMETIME AUDIOVIZIVE TË PËRGJEGJSHME, MOTIVUAR NGA INTERESI PUBLIK	10
4. PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM I CILËSISË DHE EFEKTIVITETIT TË ROLIT MBIKËQYRËS DHE RREGULLATOR TË AUTORITETIT	10
5. ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I KAPACITETEVE DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË MIRËFUNKSIONIMIT TË BRENDSHËM TË AUTORITETIT	11
TABELA E PLANIT STRATEGJIK	13

NË VEND TË HYRJES

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në tri vitet e fundit ka vijuar të ushtrojë funksionin e vet rregullator me synim rritjen e standardeve të veprimtarisë audiovizive në përputhje me interesat e publikut në Republikën e Shqipërisë. Në qendër të vëmendjes ka qenë përshtatja e ndikuar nga zhvillimi shoqëror dhe teknologjik brenda dhe jashtë kufijve dhe sfidat që këto ndryshime kanë prodhuar me kalimin e viteve. Në këtë kuadër AMA është angazhuar posaçërisht për amendimin e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si nevojë e reflektimit të direktivave të BE-së dhe e përditësimit, të diktuar nga detyrimet lidhur me transparencën e pronësisë së medias, luftën kundër piraterisë dhe shkeljes së të drejtave të transmetimit.

Një vëmendje e rëndësishme i është kushtuar harmonizimit të Direktivës së BE-së 2018/1808, e cila përmirësoi legjislacionin kombëtar në disa aspekte, si: garantimi i së drejtës për informim dhe lirisë së shprehjes; rritja e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive; mbrojtja e dinjitetit, të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve nga përmbajtjet që dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral; inkurajimi i vetërregullimit dhe bashkërregullimit si plotësues të mekanizmave legjislativë, gjyqësorë dhe administrativë; rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në përmbajtjet audiovizive; si edhe përmirësimi i edukimit mediatik të publikut si mjet për luftimin e dezinformimit.

Gjatë kësaj periudhe Autoriteti i Mediave Audiovizive kreu rishikimin e Kodit të Transmetimit, duke e pasuruar atë me parime dhe rregulla të reja për promovimin ebarazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive; parandalimin e gjuhës së urrejtjes, parandalimin e nxitjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut pavarësisht nga statusi ose pozita shoqërore, aksesin në mediat audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Kodi i Ri i Transmetimit është produkt i një procesi të gjerë të konsultimit publik, ku dhanë mendimet dhe opinionet e tyre 87 profesionistë të medias dhe përfaqësues të OSHMA-ve, 78 përfaqësues të shoqatave të grupeve të prekura të interesit, 79 ekspertë të medias dhe komunikimit, 70 përfaqësues të institucioneve qendrore

dhe vendore si edhe 17 ekspertë dhe përfaqësues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare.

Kodi i Ri i Transmetimit reflekton në mënyrë të ekuilibruar pritshmëritë e të gjitha grupeve të interesit, evoluimin e kuadrit ligjor vendas dhe ndërkombëtar si edhe rekomandimet e ekspertëve vendas dhe të huaj përkitazi standardeve dhe nevojave të tregut audioviziv shqiptar. Përkthyer në statistika, varianti përfundimtar reflekton: vërejtjet dhe sugjerimet e OSHMA-ve në masën 64%, grupeve të interesit në masën 60%, ekspertëve vendas në masën 50% dhe ekspertëve të huaj në masën 80%.

Në periudhën 2021-2023 AMA ka marrë disa nisma dhe ka mbështetur disa projekte në fushën e edukimit mediatic të publikut, me synim formësimin e një audiencë kritike, në gjendje për të kuptuar dhe për t'u përfshirë në mënyrë të përgjegjshme në media, dhe për t'u mbrojtur nga dezinformimi. Autoriteti ka qenë nismëtar i disa fushatave avokuese në mediat sociale për kundërshtimin e dezinformimit dhe teorive të konspiracionit. Në këtë kuadër autoriteti ka mbështetur organizimin e një sërë programesh trajnimi për gazetarët e rinj dhe studentët e gazetarisë si mënyrë për të zhvilluar aftësitë e të kuptuarit dhe të luftuarit e dezinformimit. Organizatat e mbështetura nga AMA kanë realizuar gjithashtu studime monitoruese lidhur me lajmet e rreme dhe rolin e edukimit mediatic. Me mbështetjen e AMA-s janë përkthyer dhe botuar edhe një sërë monografish mbi lajmet e rreme, dezinformimin, propagandën etj., duke plotësuar një boshllëk të mëparshëm në këtë fushë.

Gjatë kësaj periudhe është punuar hollësisht edhe në përfshirjen e autoritetit në rrjetet ndërkombëtare të rregullatorëve, prej të cilëve mësojmë praktikën më të mira dhe standardet më të larta të veprimtarisë audiovizive, siç është Rrjeti Mesdhetar i Autoriteteve Rregullatore, në të cilin AMA mban presidencën.

Në periudhën 2021-2023 AMA finalizoi me sukses edhe procesin e koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), duke mundësuar operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit për trajtimin dhe qasjen e barabartë të të shtatë operatorëve audiovizivë kombëtarë në veprim (publik/privat).

I. MISIONI

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka misionin të sigurojë që të gjitha shërbimet audio dhe audiovizive të përmbushin nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe moralin qytetar, në përputhje me vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht sa u përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

II. VIZIONI

AMA, si institucion i pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, nxit: (i) shumëllojshmërinë dhe cilësinë e lartë e me risi të programeve nga OSHMA-të publike e private; dhe (ii) zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimeve në përputhje me dispozitat ligjore, për përmbajtje të paanshme në kuadrin e së drejtës për informim, në respektim të përkatësisë fetare dhe politike, personalitetit, dinjitetit, të drejtave dhe lirive të tjera themelore të njeriut, duke i mundësuar kështu publikut të krijojë opinionin e vet të lirë.

III. VLERAT

Vlerat, në bazë të të cilave AMA zhvillon funksionet dhe veprimtarinë e saj:

- Mbështet lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediatike audiovizive, **motivuar nga interesi publik.**
- Ruan një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin/autorizimin dhe rregullimin e shërbimeve mediatike audiovizive, **në respektim të drejtësisë, paanshmërisë dhe konkurrencës së lirë.**
- Krijon qëndrueshmëri financiare të institucionit, nëpërmjet përdorimit të burimeve të tij me efikasitet, gjatë përmbushjes së detyrave dhe nevojave të Autoritetit, **duke u udhëhequr nga transparenca dhe llogaridhënia.**

IV. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

Objektivat e vendosura nga AMA në Strategjinë 2021-2023 janë përmbushur përgjithësisht sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit, ndonëse një pjesë prej tyre mbeten të vazhdueshme për shkak të natyrës së tyre dhe lidhjes funksionale me institucionin. Një pjesë e objektivave do të zgjaten më tej në kohë për shkak të vizionit dhe të strategjisë së entit drejt standardeve më të larta, në përputhje me zhvillimet e teknologjisë, zhvillimet e tregut mediatik, zhvillimet shoqërore, detyrimet për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit European etj.

Një nga objektivat kryesorë të AMA-s, me të cilin është punuar me kujdes gjatë këtyre viteve, mbetet ai i përmbushjes sa më mirë të nevojave të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë nga shërbimet audiovizive, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimet fetare, kulturën dhe moralin e qytetarëve, vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe veçanërisht lirinë e shprehjes.

AMA e ka nisur tashmë procesin e kontributit në përafrimin e legjislacionit tonë me orientimet e Bashkimit European, duke përafruar legjislacionin tonë me Direktivën (BE) 2018/1808 të Parlamentit European dhe të Këshillit me ndryshimet ligjore në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

AMA bashkëpunon ngushtë me AKEP-in në inspektimet e kryera lidhur me fenomenin e piraterisë së produktit audioviziv dhe operatorëve pirate që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s.

AMA si një institucion i pavarur dhe ent rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive si edhe të shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë vitit 2022 e plotësoi bordin me të gjithë anëtarët duke mbyllur vakancat.

Gjatë kësaj periudhe u realizua monitorimi i fushatave zgjedhore të muajit mars 2022, fushata e zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 dhe ajo për Bashkinë Kukës e 24 shtatorit 2023.

Në vijim të rezultateve të këtij 3-vjeçari, përbën domosdoshmëri vazhdimi i punës me vizion, përkthyer në objektiva konkretë për një sërë aspektesh, mes të cilave: ndjekja e hapave procedurale për hyrjen në fuqi të aktit nënligjor për ndryshimet në strukturën pronësore dhe rritjen e transparencës së pronësisë, përputhur me detyrimet e rrjedhura nga harmonizimi më i fundit i ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, me Direktivën e Bashkimit Evropian për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive 2018/1808; ndjekja me rigorozitet e zbatimit nga Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive të detyrimeve të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit, veçanërisht lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre; aksesimi në informacion të personave me aftësi të kufizuara; shmangia dhe ndalimi i gjuhës së urrejtjes; zgjidhja përfundimtare e mungesës së interpretëve të gjuhës së shenjave. Po kështu vazhdimi i punës do të përqendrohet edhe te: rritja e bashkëpunimit me aktorët e grupit ndër-institucional për lirinë e brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim të këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, në shërbim të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të vendit dhe vijueshmëria e transmetimeve audiovizive në nivel lokal, si një standard thelbësor për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike.

AMA gjithashtu synon të rrisë rolin e saj rregullator, por sipas rastit, edhe në ditët e ardhshme, në disa procese, zbatimi i të cilave synon të çojë përpara vendin në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Nisma të tilla janë psh. hartimi i një metodologjie për matjen e audiencave, si një ndër kriteret kryesore të realizimit të transparencës së plotë mediatike në treg, apo implementimi gradual i Aktit Evropian për Lirinë e Medias.

V.QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT

Qëllimet strategjike të AMA-s janë parashikuar për një periudhë prej 3 vjetësh, duke u detajuar me objektiva dhe me një plan veprimi, të cilat do të ndihmojnë në përmbushjen e strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për këtë periudhë kohore.

1. Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.

a. Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të konsultimit me partnerët ndërkombëtarë të angazhuar në lirinë e shprehjes dhe të medias në BE dhe rajon, me qëllim unifikimin e praktikave rregulluese të autoritetit.

b. Nisja e angazhimit të rregullatorit për njohjen dhe përdorimin e praktikave të së drejtës evropiane mbi reklamën publike, hartimin e metodologjisë për një proces transparent matje audiencash në tregun audioviziv dhe përcaktimin e parimeve për veprimtarinë e shpërndarjes së videove në platformat e mediave sociale që funksionojnë në Shqipëri.

c. Mbështetje nëpërmjet konceptit të bashkërregullimit, të nismave nga OSHMA-të apo aktorët e tjerë të lidhur me transmetimet audiovizuale, në marrjen e praktikave më të mira ndërkombëtare për përmbajtje audiovizive që u përgjigjen në nivelin më të lartë nevojave të audiencave.

2. Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive

a. Mbështetja e lirisë dhe e pluralizmit të shërbimeve mediatike audiovizive, motivuar nga interesi publik duke u kujdesur për krijimin e një mjedisi funksional mediatik që të përmbushë me transmetimet audiovizive nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe diversitetin si dhe parimin e gjithëpërfshirjes së audiencave.

b. Nxitja e shumëllojshmërisë dhe e cilësisë më të lartë të transmetimeve audiovizive në reflektim të standardeve e praktikave më të mira profesionale duke patur në vëmendje shërbimin ndaj publikut dhe vetëm publikut, ku në funksion të së drejtës për informim, publiku të krijojë i pandikuar nga çrregullimet në informacion, opinionin e vet të lirë.

c.Nxitja e prodhimeve audiovizive që përdorin dhe respektojnë gjuhën shqipe si dhe nxitja e përdorimit të gjuhës së shenjave në transmetimet audiovizive për t'u shërbyer audiencave me aftësi të kufizuar.

3. Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme, motivuar nga interesi publik

a. Mbështetja për promovimin e edukimit mediatik në transmetimet audiovizive dhe mbështetja në trajnime të vazhdueshme të stafëve që krijojnë përmbajtje audiovizive në drejtim të mbrojtjes dhe reagimit ndaj çrregullimeve në informacion.

b. Mbështetja nëpërmjet partnerëve në realizimin e edukimit mediatik të audiencave dhe nxitjen e mendimit kritik të tyre, me qëllim depërtimin me trajnime të edukimit mediatik te tipologji audiencash si prindërit, fëmijët në shkolla, mësuesit në shkolla dhe edukatorët në kopshte.

c.Mbështetja dhe përfshirja e audiencave dhe e palëve të tjera të interesuara për t'u angazhuar aktivisht në gjetjen e zgjidhjeve të çështjeve të ndjeshme që lidhen me transmetimet audiovizive.

4. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit

a. Rritja e kapaciteteve për monitorimin cilësor dhe sasior të transmetimeve audiovizive në funksion të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit duke shtuar shqyrtimet cilësore që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çrregullimeve në informacion, proceset zgjedhore etj. Modernizim teknik dhe teknologjik të monitorimit përmes përdorimit të soft-eve të ndryshme të avancuara.

b. Fuqizimi i kapaciteteve teknike për zbulimin e piraterisë audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të transmetimit në koordinim më të gjithë faktorët institucionalë. Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve dhe e infrastrukturës teknike, për matjen e përputhshmërisë së cilësisë së shërbimit audioviziv.

c.Ruajtja e një sistemi të drejtë dhe të hapur për licencimin/autorizimin dhe rregullimin e shërbimeve mediatike audiovizive, në respektim të drejtësisë, të paanshmërisë dhe të konkurrencës së lirë. Nxitja e lehtësimit të procedurave në një masë të konsiderueshme nëpërmjet aplikimeve virtuale për licencat/autorizimet.

5. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit

a. Informatizimi i aktiviteteve të institucionit brenda një sistemi të qendërzuar menaxherial dhe publikimi i përmbajtjeve të webit të autoritetit në formë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

b. Mbështetja e procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të brendshëm të autoritetit, proces që i ndihmon transparencës dhe llogaridhënies. Digjitalizimi i arkivës fizike të dokumentacionit të autoritetit.

b. Trajnime të vazhdueshme të stafit të autoritetit dhe veçanërisht zhvillim të kapaciteteve në trajnime të nëpunësve të rekrutuar rishtas si pasojë e implementimit të strukturës së re organizative të autoritetit.

TABELA E PLANIT STRATEGJIK

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Kuadri ligjor, aktet nënligjore dhe politikat

Përgatitja e një akti nënligjor për ndryshimet në strukturën pronësore dhe deklarin e pronarit përfitues, me qëllim rritjen e transparencës së pronësisë mediatike.	Bashkëpunimi me drejtorinë ligjore të AMA-s dhe realizimi i procesit të konsultimit publik me palët e interesit dhe institucionet e tjera shtetërore.	Pluralizmi i lirisë së medias dhe medias dhe transparencën rritet më tej në praktikë në baza progresive, pas ndryshimeve legjislativë dhe veprimeve të ndërmarra nga AMA në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.	X			Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
Përgatitja e një akti të ri nënligjor për funksionimin e platformave të shpërndarjes së videove (VSP), si psh. YouTube, Facebook, Instagram, TikTok, etj., dhe VSP të tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.	Bashkëpunimi me drejtorinë ligjore të AMA-s dhe ekspertë të fushës së medias dhe legjislacionit të BE-së për hartimin e përmbajtjes.	Përshtatja e mekanizmave rregullues dhe monitorues të AMA-s me zhvillimet e shpejta të realitetit teknologjik në fushën e mediave audiovizive.	X			Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
Angazhimi i rregullatorit për ndryshimet ligjore sa i takon rritjes së transparencës së OSHMA-ve për reklamën institucionale.	Bashkëpunimi me drejtorinë ligjore dhe të legjislacionit ndërkombëtar të AMA-s dhe ekspertë të fushës së medias dhe legjislacionit të BE-së për hartimin e përmbajtjes.	Identifikimi i mekanizmave bashkëkohorë për forcimin e nivelit të transparencës së informacionit mbi tregun mediatik audioviziv për publikun.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
Angazhimi i autoritetit rregullator për nxitjen e përgatitjes së metodologjisë për realizimin e procesit të matjes së audiencave mediatike.	Ndryshime në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, për të integruar konceptin e matjes së audiencës. Organizim tryezash konsultative me OSHMA-të në mënyrë që të gjendet një mekanizëm për monitorim të tregut mediatik.	Identifikimi i mekanizmave bashkëkohorë për forcimin e nivelit të transparencës së informacionit mbi tregun mediatik audioviziv për publikun. Promovimi i një dialogu ndërinstitucional, me përfshirjen e palëve të interesuara, me qëllim garantimin e një procesi të rregulluar të matjes së audiencave audiovizive.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.

Angazhimi i AMA-s për frenimin e piraterisë televizive dhe funksionimit të licencës audiovizive.	Propozime për ndryshime në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, për të forcuar luftën kundër piraterisë dhe plotësime të tjera në lidhje me konceptet e shtrirjes dhe funksionimit të licencës audiovizive.	Parandalim dhe ulje e piraterisë televizive dhe plotësimi i mangësive në ligj.		X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit
Nxitja e hartimit të një Plani kombëtar ndërinstitucional Veprimi për Sigurinë e Gazetarëve.	Mbështetja e organizimit të një studimi tregu, të tryezave këshillimore ndërinstitucionale dhe rrjetit gjithëpërfshirës së informacionit për denoncimin e shkeljeve.	Forcimi i të drejtave të gazetarëve në Republikën e Shqipërisë, rritje e besueshmërisë për rregullatorin, në aspektet e ushtrimit të profesionit gazetaresk.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
Ndërhyrja në kuadrin rregullator të brendshëm të AMA-s mbi amendime në aspekte të lidhura me mënyrën dhe fashën orare të reklamës, mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, promovimin e veprave evropiane, duke përdorur si shembull acquis të BE-së.	Bashkëpunimi me drejtoritë ligjore të AMA-s dhe ekspertë të fushës së medias dhe legjislacionit të BE-së për hartimin e përmbajtjes.	Përmirësimi i legjislacionit ekzistues të brendshëm, në harmonizim me Direktivën e BE 2018/1808.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
Bashkëpunim i shtuar bilateral dhe multilateral me autoritetet rregullatore të vendeve anëtare të BE-së (ERGA), të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (MNRA), EPRA, Observatori Evropian, etj	Pjesëmarrje në aktivitete dhe takime jashtë vendit, organizim takimesh konsultative të ndërsjella me partnerët.	Forcimi i kapaciteteve të stafit të AMA-s.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
Fokus në raportim periodik mbi përafrimin e legjislacionit pranë strukturave të Bashkimit Evropian.	Bashkëpunimi me drejtorinë e legjislacionit ndërkombëtar të AMA-s dhe ekspertë të fushës së medias dhe legjislacionit të BE-së.	Përmirësimi i legjislacionit ekzistues të brendshëm, në harmonizim me Direktivën e BE 2018/1808.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare
Rregullore për përdorimin e sistemit të të dhënave (RDS), në transmetimet audio FM dhe DAB.	Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse të AMA-s dhe ekspertë të fushës.	Akti synon të rregullojë dhe të caktojë kodin e identifikimit (PI) si dhe emërtimin (PS) të kanalit programor të transmetimeve audio, në zbatim të standardeve ndërkombëtare.				Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Infrastruktura e informacionit dhe njohurive

Buletini Periodik i Këshillit të Ankesave	Përmbledhje statistikash të përgjithshme dhe të veçanta sipas zërave lidhur me ankesat e administruara nga Këshilli i Ankesave. Evidentimi i prirjeve sasiore dhe cilësore, evidentimi i problematikave sociale dhe ndjeshmërive etike, standardeve profesionale të tregut audioviziv shqiptar si edhe promovimi i studimeve, analizave dhe vlerësimeve përkatëse, përfshirë dhe ekspertizën e jashtme.	Publikimi i një baze të dhënash të dobishme për palët e interesuara, OSHMA-të, studiuesit e tregut audioviziv, studentët, institucionet, qytetarët etj.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme motivuar nga interesi publik.
Monitorimi dhe analiza tematike e përmbajtjeve audiovizive	Shtimi i shqyrtimeve cilësore që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e çrregullimit informativ etj. Përmirësimi teknologjik dhe logjistik (infrastruktura digjitale e monitorimit). AMA ka si synim të nxisë procesin e modernizimit teknik dhe teknologjik të Studios/infrastrukturës së regjistrimit dhe të monitorimit përmes aksesit që duhet të ketë për çdo përmbajtje të regjistruar më parë, e cila do të jetë audiovizive, ose audio dhe përmes përdorimit të soft-eve të ndryshme të avancuara për të bërë të mundur shqyrtimin linear dhe robotik (me fjalëkyç) të përmbajtjeve të regjistruara më parë.	Identifikimi i mekanizmave bashkëkohorë për forcimin e nivelit të transparencës së informacionit mbi tregun mediatik audioviziv për publikun.		X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit.
Mbrojtja e të miturve nga përmbajtjet audiovizive dhe reklamat audiovizive	Për te gjitha rastet e identifikuar si të papërshtatshme shqyrtimi i tyre dhe adresimi te OSHMA-te.	Mbrojtja e dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral.	X	X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Veprimtaritë e licencimit

Automatizim i procesit të licencimit të OSHMA-ve	Lehtësimi i mëtejshëm i barrierave të mundshme ligjore/administrative për OSHMA-të operuese në treg, nëpërmjet rritjes së transparencës mbi tarifatat që paguhen, si dhe procesin e pajisjes/rinovimit me licencë/autorizim.	Mbështetje nëpërmjet konceptit të bashkërregullimit, të nismave nga OSHMA-të apo aktorët e tjerë të lidhur me transmetimet audiovizuale, në marrjen e praktikave më të mira ndërkombëtare për përmbajtje audiovizive që u përgjigjen në nivelin më të lartë nevojave të audiencës.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive
--	--	--	---	---	---	--

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Transmetimet numerike

Ndjekja e zbatimit të akteve përfundimtare të miratuara në konferencën ndërkombëtare WRC- 19 dhe WRC- 23. Lirimi i brezit të Dividendit Digjital	Bashkëpunimi dhe koordinimi me MIE dhe AKEP, në lidhje me zbatimin e strategjive që duhet të ndiqen nga qeveria shqiptare, në lidhje me politikat spektrale.	Harmonizimi i përdorimit të spektrit të frekuencave, duke garantuar një përdorim efikas të spektrit në përputhje me politikat e BE-së në fushën e transmetimeve audiovizive.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive
Ndjekja e zbatimit të akteve përfundimtare	Ndjekja e procesit të liritimit të brezit 700 MHz (DD2), në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në aktet nënligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me të gjithë palët e përfshira në këtë proces dhe ndjekja e zbatimit të planit të punës.	Lirimi i brezit 700 MHz dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e rrjeteve me shpejtësi të lartë 5G. Garantimi i vazhdimësisë së transmetimeve audiovizive numerike, si dhe shmangia e interferencave të brendshme dhe të jashtme, pas liritimit të brezit DD2.	X	X		Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive
Ndjekja e marrëveshjeve shumëpalëshe me vendet e rajonit.	Ndjekja dhe zbatimi i marrëveshjeve shumëpalëshe me vendet e rajonit 1, ku bën pjesë edhe Shqipëria si dhe koordinimi i frekuencave me këto shtete lidhur me përdorimin e frekuencave audio/audiovizive. Njoftimi dhe regjistrimi i frekuencave audio/audiovizive në përdorim nga ALB në ITU.	Shmangia e interferencave të mundshme me vendet e Rajonit 1, ku bën pjesë Shqipëria. Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare multilaterale dhe bilaterale në kuadër të koordinimit të brezit audio/audioviziv.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive
Rregullimi i teknologjive të reja në shërbimet e transmetimit audio	Bashkëpunim me palët e përfshira në këtë proces. Sigurimi i kuadrit rregullator që do të rregullojë teknologjinë e re DAB+	Rregullimi i transmetimeve të reja audio në teknologjinë DAB+	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive
Implementimi i teknologjisë së transmetimit audio DAB+	Studimi dhe analizimi i një zbatimi teknik të planifikimit të frekuencave DAB+	Rritja e cilësisë së shërbimit dhe diversifikimi i programacionit të shërbimit audio, nëpërmjet teknologjisë së re digjitale DAB+	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Monitorimi i spektrit radiofrekuencor

Monitorimi i shfrytëzimit të spektrit frekuencor audio/audioviziv	Monitorim periodik i shfrytëzimit të spektrit audio/audioviziv me qëllim: shmangien e interferencave të dëmshme të shkaktuara në apo nga brezi audio/ audioviziv, identifikimin mbi zbatueshmërinë e kushteve të licencës nga ana e operatorëve audio/audiovizivë, mbështetjen e procesit të planifikimit të spektrit audio/audioviziv.	Rregullimi i tregut audio/audioviziv lidhur me përdorimin e frekuencave me efektivitet, si dhe duke shmangur interferencat e mundshme. Sigurimi i konkurrencës së ndershme në treg.	X	X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit
---	---	---	---	---	---	---

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe të përputhshmërisë

Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve dhe infrastrukturës teknike, për matjen e përputhshmërisë së cilësisë së sinjalit numerik audioviziv.	Ngritja e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave Audiovizive, në 12 qarqe të vendit dhe i qendëruar në Tiranë, ku në kohë reale do të bëhet kontrolli i subjekteve televizive që transmetojnë në teknologjinë DVB-T2.	Rritja e aftësisë monitoruese në kontrollin e cilësisë së marrjes së sinjaleve në zonat e mbulimit, zgjidhja e ankesave të publikut për cilësinë e transmetimit të sinjaleve audiovizive, shfrytëzimi me efektivitet i burimeve të fundme frekuencore, pa interferenca të dëmshme, menaxhimin e kapaciteteve të transmetimit të çdo mux-i.	X	X		Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit
Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve dhe infrastrukturës teknike, për matjen e përputhshmërisë së cilësisë së shërbimit audioviziv.	Ngritja e një sistemi të qendëruar monitorimi. Kjo do të ndihmonte në një kontroll më të mirë të situatës së cilësisë së sinjalit, ndryshimet dhe mbartjet e ndryshme të kanaleve nga një operator në tjetrin, si dhe kontroll të televizioneve vendore, për programet e transmetuara nga këto të fundit.	Rritja e aftësisë monitoruese të programacionit të subjekteve vendore, gjë që ndihmon si në një kontroll më të mirë të sinjalit të transmetimit si në një kontroll më rigoroz të programeve që ato transmetojnë, duke monitoruar më mirë respektimin e së drejtës së transmetimit.		X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit.
Fuqizim i kapaciteteve teknike për zbulimin e piraterisë televizive.	Implementimi i një infrastrukture teknike të përditësuar, për të evidentuar përmbajtjet audiovizive të paligjshme, të transmetuara në rrjetet e reja të komunikimit (IPTV, OTT).	Identifikimi i subjekteve që transmetojnë (piratojnë) përmbajtje audiovizive pa autorizim nga AMA.	X	X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit.

Fuqizim i kapaciteteve teknike për zbulimin e piraterisë televizive.	Trajnim teorik dhe teknik i stafit specifik të AMA-s, që merret veçanërisht me njohjen e teknologjive të reja të IPTV/OTT.	Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të burimeve të institucionit për transmetimet në rrjetet e reja të komunikimit (IPTV/OTT).	X	X		Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit
Lufta kundër piraterisë	Bashkëpunim dhe koordinim i përbashkët me institucionet e tjera, si AKEP-i, Policinë e Shtetit dhe strukturën kundër Krimin Ekonomik. Ngritja e grupeve të përbashkëta të inspektimit në subjektet ISP.	Bashkëpunimi me AKEP-in dhe institucionet e tjera ligjzbatuese do të ndihmojë në parandalimin dhe uljen e këtij fenomeni në vitet në vazhdim.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.
E drejta e transmetimit	Rritje e rolit aktiv të rregullatorit në mbikëqyrjen për zbatimin e të drejtave të transmetimit dhe shmangien e piraterisë së paligjshme audiovizive. Takime dhe tryeza me operatorët dhe ndërgjegjësim i tyre mbi respektimin e të drejtave të transmetimit.	Forcimi i kapaciteteve të stafit të AMA-s.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare.

Frekuencat dhe zhvillimet teknologjike

Infrastrukturë IT, vlerësim të sistemeve dhe upgrade i rrjetit.	Infrastruktura ekzistuese e shërbimeve IT mbështetet në një Platformë HW të amortizuar dhe jo të aftë për të përballuar sistemet moderne që pritet të implementohen.	Ndërtimi i një infrastrukture të re të bazuar në nyje të virtualizuara me kapacitet të lartë dhe që kanë teknologji të fundit të menaxhimit të hapësirave të storage dhe të burimeve procesuese. Kjo platformë duhet të jetë redundant (1+1) dhe me aftësinë që kjo redundancy të arrihet brenda të njejtit site por me mundësinë dhe për në site të ndryshme.	X	X		Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit
---	--	--	---	---	--	--

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimi i audiencave

Matje opinioni dhe verifikim standardi për operatorin publik dhe operatorët e tjerë audiovizivë	Një studim kombëtar tregu, me synim ballafaqimin e perceptimeve të OSHMA-ve dhe publikut shqiptar lidhur me standardet etike të ofertës audiovizive.	Publikimi i një baze (për herë të parë) kombëtare të dhënash të dobishme për të gjitha grupet e interesit: OSHMA-të, studiuesit e tregut audioviziv, studentët, institucionet, qytetarët etj.	X	X		Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme motivuar nga interesi publik
Rrjeti i Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave	Riaktivizim i Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave dhe hartimi i një kalendari të qëndrueshëm vjetor të takimeve të Këshillit të Ankesave me këto borde.	Rritja e aftësisë monitoruese të programacionit të subjekteve vendore, gjë që ndihmon si në një kontroll më të mirë të sinjalit të transmetimit si në një kontroll më rigoroz të programeve që ato transmetojnë, duke monitoruar më mirë respektimin e së drejtës së transmetimit.	X	X	X	Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme motivuar nga interesi publik
Shqyrtimi i ankesave	Zbatimi i Kodit të Rishikuar të Transmetimit për praktikën e dërgimit të shqyrtimit të ankesave.	Zbatimi i ligjit 97/2013 i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit.	X	X	X	Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit.
Aktivitete Edukimi Mediatik me fokus sensibilizimin publik	Fushatë publicitare informimi, ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi për edukimin mediatik.	Krijimi i sa më shumë kanaleve komunikuese me publikun dhe OSHMA-të, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sektorit të veçantë, që Këshilli i Ankesave ka në faqen e internetit të AMA-s, si dhe trajtimi profesional i ankesave të adresuara në AMA.				Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme motivuar nga interesi publik

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Financat

Pavarësia financiare e institucionit dhe përgjegjësia në menaxhimin e financave	Pavarësia financiare e AMA-s dhe përgjegjësia në menaxhimin e financave, respektimi i akteve ligjore dhe akteve nënligjore në praktikën e kontabilitetit dhe raportimi për realizimin e treguesve financiarë të vitit kalendarik. Shqyrtimi i projektbuxhetit bazuar në një seri treguesish të të ardhurave dhe të shpenzimeve, duke siguruar vazhdimësinë e funksionimit të AMA-s.	Efikasitet në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, përqendruar në realizimin e objektivave të AMA-s.	X	X	X	Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit
Raportimi i brendshëm financiar në lidhje me kanalizimin e burimeve financiare të autoritetit	Zhvillimi i strukturës së raportimit, duke kombinuar realizimin e elementeve që përbëjnë burimet e të ardhurave hyrëse me elementët dalës (shpenzimet/ investimet). Raportimi në nivelet e menaxhimit dhe vendimmarrjes.	Vlerësim i rrezikut dhe minimizimi i situatave të paparashikuara të lidhura me shpenzimet.	X	X	X	Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Komunikimi dhe publikimi

Publikim përmbajtjesh për strukturën pronësore të mediave	Botimi i materialeve dhe informacioneve transparente për pronësinë e medias.	Pluralizmi i lirisë së medias dhe medias dhe transparencja rritet më tej në praktikë në baza progresive, pas ndryshimeve legjislative dhe veprimeve të ndërmarra nga AMA në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare
Mbështetje në publikim studimesh dhe raportesh për mbrojtjen e gazetarëve dhe luftën ndaj dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes	Rritja e kapaciteteve të AMA-s në botime të studimeve dhe raporteve për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe në luftimin e dezinformimit.	Forcimi i të drejtave të gazetarëve në Republikën e Shqipërisë, rritje e besueshmërisë së rregullatorit në aspektet e mbështetjes për ushtrimin e profesionit gazetaresk me standardet më të larta.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare
Akses informacioni në AMA për personat me aftësi të kufizuar dëgjimi dhe shikimi	Sigurimin e aksesit të informacioneve dhe materialeve që prodhohen në formatin e duhur për personat me aftësi të kufizuar.	Mbrojtjen më të mirë të të drejtave dhe lirive të njeriut pavarësisht nga statusi ose pozita shoqërore, aksesin në mediet audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi ndryshe.	X	X	X	Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive

Fusha e veprimit	Veprimtaritë me përparësi	Rezultati i pritshëm	Afati			Qëllimi strategjik
			2024	2025	2026	

Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe organizative

Publikim përmbajtjesh për strukturën pronësore të mediave	Botimi i materialeve dhe informacioneve transparente për pronësinë e medias.	Pluralizmi i lirisë së medias dhe medias dhe transparencja rritet më tej në praktikë në baza progresive, pas ndryshimeve legjislative dhe veprimeve të ndërmarra nga AMA në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.	X	X	X	Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare
Automatizimi i proceseve të AMA-s	Dixhitalizimin e protokollit elektronikisht për çdo dokument hyrës apo dalës nga institucioni. Digjitalizimi i të gjithë dokumentacionit hard copy dhe ruajtja në forme elektronike; Administrimi i automatizuar i proceseve të Njësisë së Arkivë-Protokollit.	Digjitalizimi dhe automatizimi i të gjithë aktiviteteve operacionale të institucionit duke i ndërthurur të gjithë proceset brenda një sistemi menaxherial të vetëm. Reduktim të kohës së konsumuar në ofrimin e shërbimit, Rritje të saktësisë së punonjësve duke eliminuar gabimet e mundshme. Rritje e sigurisë së informacionit duke eliminuar mundësinë për humbje të dhënash.	X	X	X	Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit
Menaxhimi me efektivitet i burimeve njerëzore sipas legjislacionit në fuqi dhe strukturës organizative të AMA-s.	Zhvillimi i Burimeve njerëzore nëpërmjet rritjes së kompetencave profesionale të stafit në përputhje me ndryshimet ligjore në vijimësi dhe risitë e zhvillimit teknologjik.	Me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuohet në cilësi më të mirë, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës.	X	X	X	Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit

Menaxhimi me efektivitet i burimeve njerzore sipas legjislacionit në fuqi dhe strukturës organizative të AMA-s.

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerzore në tërësi e veçanërisht i nëpunësve të rekrutuar rishtas si pasojë e implementimit të strukturës së re organizative mbetet një ndër prioritetet kryesore të AMA-s.

Me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuohet në cilësi më të mirë, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës.

X

X

X

Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit